



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCËVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BUXHETIT
DREJTORIA E MENAXHIMIT TË BUXHETIT

Nr. 9860/1 / prot.

Tiranë, më 30.05.2023

Lënda: Dërgohet Udhëzimi “Për procedurat standarte të monitorimit të buxhetit në Njësitë e Qeverisjes Qendrore”.

MINISTRIA/ INSTITUCIONI _____

Mbështetur në pikën 4, të nenit 102, të Kushtetutës, dhe në zbatim të nenit 65, të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, bashkëlidhur iu dërgojmë udhëzimin nr. 14, datë 30/05/23 Për procedurat standarte të monitorimit të buxhetit në Njësitë e Qeverisjes Qendrore”.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

MINISTËR
Delina Ibrahimaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BUXHETIT

9860

30. 5 2023

UDHËZIM

Nr. 14 Datë 30.5.2023

“PËR PROCEDURAT STANDARDE TË MONITORIMIT TË BUXHETIT NË NJËSITË E QEVERISJES QENDRORE”

Në mbështetje të nenit 104, pika 4 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 65 të Ligjit Nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, Ministri Përgjegjës për Financat:

UDHËZON:

I. TË PËRGJITHSHME

1. Qëllimi i këtij udhëzimi është përcaktimi i procedurave dhe afateve që duhet të ndjekin të gjitha njësitë e qeverisjes qendrore gjatë monitorimit të zbatimit të buxhetit për performancën financiare dhe jo-financiare, produktet dhe objektivat e politikës të realizuar për çdo program, të përcaktuar në vitin e parë të dokumentit përfundimtar të programit buxhetor afatmesëm.
2. Ky është një udhëzim i përhershëm (standard), në të cilin përcaktohen: roli, përgjegjësitë dhe detyrat e Grupit të Menaxhimit Strategjik (GMS), procedurat që duhet të ndjekin Ekipet e Menaxhimit të Programeve (EMP) për monitorimin e zbatimit të buxhetit vjetor me qëllim realizimin e objektivave të synuara, të produkteve të parashikuara si dhe për përgatitjen e raporteve periodike dhe vjetore të monitorimit.
3. Në këtë udhëzim përcaktohen edhe roli i Ministrisë përgjegjëse për Financat në monitorimin e procesit të zbatimit të buxhetit, në monitorimin e performancës financiare të objektivave të politikës së programit dhe produkteve përkatëse si edhe afatet e paraqitjes së raporteve të monitorimit në Ministrinë përgjegjëse për Financat dhe të publikimit të tyre.
4. Monitorimi, është një proces vlerësimi performance i cili realizohet nëpërmjet krahasimit të treguesve të performancës së synuar me treguesit faktikë të realizuar. Monitorimi ka për qëllim:
 - Të ndjekë arritjen e qëllimit dhe objektivave të synuar, të përcaktuar në deklaratën e politikës së programit për vitin e parë të programit buxhetor afatmesëm, nëpërmjet krahasimit të treguesve të synuar të performancës me treguesit faktikë të tyre.
 - Të evidentojë nëse realizimi i produkteve është në përputhje me planin, dhe nëse jo të propozojë / rekomandojë ndërmarrjen e veprimeve korrigjuese duke ndryshuar alokimin e burimeve. Në rast rialokimi të burimeve, të evidentojë impaktin e mundshëm në performancën e objektivave të lidhura me to.
 - Të sigurojë informacion i cili mund të përdoret për të përmirësuar procesin e planifikimit dhe menaxhimit të buxhetit.

5. Monitorimi i objektivave bëhet bazuar në treguesit përkatës të performancës, ndërsa monitorimi i produkteve bëhet në sasi dhe në vlerë. Pra monitorimi është procesi që lidh realizimin e objektivave dhe produkteve me fondet përkatëse të planifikuara për arritjen e tyre.

II. ROLET DHE PËRGJEGJËSITË NË PROCESIN E MONITORIMIT TË BUXHETIT

Roli i Ministrisë përgjegjëse për Financat në procesin e monitorimit.

6. Ministria përgjegjëse për Financat ka dy role në menaxhimin dhe monitorimin e buxhetit vjetor:
- 6.1 Ministria përgjegjëse për financat siguron që zbatimi i buxhetit nga Njësitë e Qeverisjes Qendrore (NJQQ) kryhet në përputhje me parashikimet e ligjit vjetor dhe i rekomandon NJQQ-ve marrjen e masave korrigjuese në momentin kur konstatohen devijime nga këto parashikime.
 - 6.2 Ministria përgjegjëse për financat, mbështetur në informacionin mbi performancën e objektivave të politikës dhe produkteve të programeve buxhetore të NJQQ kundrejt vitit të parë të dokumentit përfundimtar të PBA (Programi Buxhetor Afatmesëm), i bën propozime Këshillit të Ministrave për ri-alokimin e burimeve, për rishpërndarje të fondeve buxhetore ndërmjet programeve duke respektuar kufijtë e përcaktuar në ligjin vjetor ose duke propozuar një rishikim të buxhetit.
7. Ministria përgjegjëse për financat merr raporte progresi për performancën e objektivave, produkteve dhe të shpenzimeve nga njësitë e qeverisjes qendrore dhe mbështetur në këto raporte, Ministria përgjegjëse për financat duhet të përgatisë një raport “Komente dhe rekomandime mbi raportet e monitorimit të NJQQ” i cili trajton këto çështje kryesore:
- a. “Vlerësim i përgjithshëm mbi arritjen e qëllimeve dhe objektivave të politikës për periudhën e monitoruar.
 - b. “Vlerësim mbi performancën e objektivave, ku paraqitet një analizë mbi statusin e realizimit të objektivave të programit, bazuar në treguesit e performancës të synuar për t’u arritur.
 - c. “Vlerësim mbi performancën dhe statusin e produkteve kryesore”, ku paraqitet analiza mbi performancën dhe statusin e produkteve me prioritet të lartë¹ si edhe i produkteve problematike i shoqëruar me argumentimet përkatëse të paraqitura në raport.
 - d. Informacion mbi “Buxhetimin e përgjithshëm gjinor”, ku paraqitet analiza e treguesve mbi performancën dhe statusin e produkteve që adresojnë barazi gjinore.
 - e. “Karakteristika kryesore të performancës së shpenzimeve” ku paraqitet analiza e realizimit të planit të shpenzimeve të çdo programi dhe të gjithë programeve të Njësisë së Qeverisjes Qendrore”, sipas të dhënave të paraqitura në raport.
 - f. “Të dhënat mbi masën e ndryshimit të planit të buxhetit të NJQQ, së bashku me argumentet përkatëse”
 - g. Informacion mbi publikimin e raporteve të monitorimit nga ana e NJQQ.
 - h. “Komente të tjera”, ku jepen komentet dhe rekomandimet e Ministrisë përgjegjëse për Financat lidhur me formën dhe përmbajtjen e raportit të monitorimit të paraqitur nga NJQQ.
 - i. Përfundime, ku Ministria e Financave rekomandon masat kryesore korrigjuese që duhet të ndërmerret çdo NJQQ, kur gjykohet e nevojshme në bazë të vlerësimeve sipas pikave të

¹Kjo nënkupton që raporti do të përqendrohet vetëm mbi performancën e produkteve me prioritet të lartë dhe mbi produkte të tjerë për të cilët performanca ndryshon rrënjësisht nga planifikimi.

mësipërme të këtij neni, përfshirë edhe masat konkrete korigjuese që do të ndërmarrë vetë Ministria e Financave për tërësinë e buxhetit.

8. “Komentet dhe rekomandimet mbi raportet e monitorimit të NJQQ, publikohen në faqen zyrtare të ministrisë përgjegjëse për Financat.
9. “Komentet dhe rekomandimet mbi raportet e monitorimit të NJQQ, paraqiten në seancat dëgjimore. që organizohen në Ministrinë përgjegjëse për Financat, me secilën Njësi të Qeverisjes Qendrore në kuadër të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm për vitet në vijim.

Përgjegjësia e Kryetarit të Grupit të Menaxhimit Strategjik

10. Titullari është kreu i organit qendror të njësisë së qeverisjes qendrore dhe është përgjegjës për miratimin e rregullave specifike dhe procedurave që duhet të ndiqen në procesin e monitorimit në përputhje me kërkesat e këtij udhëzimi si dhe udhëzimeve plotësuese të tij.
11. Titullari i njësisë së qeverisjes qendrore është Kryetari i Grupit të Menaxhimit Strategjik (GMS) të njësisë që ai mbulon. Ai ka përgjegjësi për procesin e monitorimit për njësinë e qeverisjes qendrore që mbulon në përputhje me procedurat dhe kërkesat e përshkruara në këtë udhëzim.
12. Titullari i njësisë së qeverisjes qendrore ka përgjegjësi për performancën e objektivave dhe produkteve të identifikuar për çdo program, për të cilat janë alokuar fonde buxhetore me buxhetin respektiv të miratuar.
13. Titullari i njësisë së qeverisjes qendrore ka përgjegjësi për konfirmimin ose rishikimin e raporteve të monitorimit për të gjitha programet, të konfirmuara nga nëpunësi autorizues.
14. Titullari në rolin e Kryetarit të Grupit të Menaxhimit Strategjik ka përgjegjësi të garantojë pjesëmarrjen e Nëpunësit Autorizues dhe Drejtuesit të çdo programi buxhetor, në seancat dëgjimore të buxhetit të organizuara në Ministrinë e Financave me çdo njësi të qeverisjes qendrore për të diskutuar në lidhje me rekomandimet dhe konkluzionet e përgatitura nga Ministria e Financave për raportet e monitorimit për njësitë respektive të qeverisjes qendrore.

Përgjegjësia e Nëpunësit Autorizues në procesin e monitorimit

15. Nëpunësi Autorizues është nëpunësi i nivelit më të lartë të menaxhimit të njësisë së qeverisjes qendrore, përgjegjës për zbatimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit në të gjitha strukturat dhe programet buxhetore, duke përfshirë planifikimin, zbatimin, monitorimin e kontrolleve të risqeve të lidhura me zbatimin e buxhetit, kontabilitetin dhe raportimin financiar të njësisë së qeverisjes së përgjithshme. Nëpunësi autorizues në njësitë e qeverisjes qendrore është punonjësi i administratës publike i nivelit më të lartë të shërbimit civil, pra respektivisht sekretari i përgjithshëm.
16. Mbi bazën e rregullave të brendshme dhe procedurave të miratuara nga titullari i njësisë së qeverisjes qendrore, përgjegjësitë për monitorimin e buxhetit vjetor duhet të shpërndahen nga nëpunësi autorizues tek drejtuesit e programeve.
17. Nëpunësi Autorizues është koordinatori i Grupit të Menaxhimit Strategjik dhe ka përgjegjësi të plotë për koordinimin e procesit të monitorimit të buxhetit vjetor. Ai është përgjegjës për monitorimin në mënyrë periodike dhe të vazhdueshme të performancës së objektivave dhe performancës së produkteve në sasi dhe vlerë, si dhe për propozimin e zgjidhjeve tek titullari për përmirësimin e performancës kur identifikohen shmangie të mëdha ndaj planit.
18. Nëpunësi autorizues, ka përgjegjësi të raportojë tek Nëpunësi i Parë Autorizues në mënyrë periodike çdo katër muaj, por jo më vonë se data 30 e muajit pasardhës, raportet e monitorimit të zbatimit të buxhetit për performancën financiare, produktet dhe objektivat e politikës, të realizuar për çdo program të përcaktuar në vitin e parë të dokumentit përfundimtar të programit buxhetor afatmesëm.

sipas formateve të raporteve dhe anekseve të gjeneruara në modulën e BPPM (Menaxhimi i Portofolit të Planifikimit Buxhetor) në sistemin AFMIS (Sistemi Informatik i Menaxhimit Financiar) dhe standardeve të vendosura konform këtij udhëzimi.

19. Përgjegjësitë e Nëpunësit Autorizues në rolin e Koordinatorit të Grupit të Menaxhimit Strategjik, gjatë procesit të monitorimit të buxhetit vjetor janë:

19.1 Aprovimi ose kthimi për rishikim i raporteve të monitorimit të gjeneruara nga moduli BPPM, në sistemin AFMIS, të aprovuara nga Drejtuesi i Ekipit të Menaxhimit të Programeve (DEMP), për të gjitha programet.

19.2 Ndërmarrja e veprimeve të mëposhtme që lidhen me:

- i. Miratimin ose kthimin për rishikim të sasive të planifikuara të rishikuara për produktet që preken nga një transferim buxhetor.
- ii. Miratimin ose kthimin për rishikim të sasive faktike të produkteve në fund të çdo katërmujori, për efekt të përgatitjes së raporteve të monitorimit.
- iii. Miratimin ose kthimin për rishikim të treguesve faktikë të performancës në fund të çdo katërmujori, për efekt të përgatitjes së raporteve të monitorimit.
- iv. Vlerësimin e situatës së përgjithshme të realizimit të performancës së synuar të qëllimit dhe objektivave të programit të shpenzimeve dhe produkteve.
- v. Analizën dhe vlerësimin e shpjegimeve të dhëna në lidhje me deviacionet më të theksuara nga plani, të performancës së produkteve. Për qëllim të raportimit, shmangie të theksuara nga plani do të konsiderohen shmangiet me mbi 15% nga plani (për të gjithë treguesit) për raportimin e parë dhe të dytë të vitit; dhe shmangiet me mbi 5% nga plani për raportin e tretë (vjetor) të monitorimit.
- vi. Vlerësimin e masave korrektuese që propozohen të ndërmerren, përcaktimin nëse duhen ndërmarrë veprime të mëtejshme dhe ku do të konsistojnë ato.
- vii. Përcaktimin e rishpërndarjeve ndërmjet programeve, që mund të miratohen.
- viii. Kërkimin e amendimeve për një raport të Ekipit të Menaxhimit të Programit, në qoftë se është e nevojshme.
- ix. Aprovimin dhe firmosjen e një raporti të konsoliduar mbi të gjitha programet dhe dorëzimi i këtij raporti tek Nënpunësi i Parë Autorizues në Ministrinë e Financave.

Përgjegjësitë e Drejtuesit të Programit

20. Drejtuesit e programit janë përgjegjës, përpara nëpunësit autorizues, për monitorimin e objektivave dhe të produkteve për programin përkatës dhe propozimin e masave korrigjuese në rastet kur kjo është e nevojshme.

21. Drejtuesit e programit janë përgjegjës përpara nëpunësit autorizues për raportimin në kohë, dhe sipas standardeve të përcaktuar në këtë udhëzim për programin përkatës që drejton.

22. Drejtuesit e programit kanë përgjegjësinë për të marrë pjesë në takimet e Grupit për Menaxhimin Strategjik, duke marrë pjesë në çdo diskutim si dhe vendim-marrjet përkatëse që kanë ndikim mbi programin e tyre.

23. Në mënyrë më specifike, Drejtuesit e programit janë përgjegjës për:

- a. Hartimin e planit katërmujor të produkteve në sasi dhe në vlerë duke respektuar tavanet e përcaktuar në ligjin e buxhetit vjetor.

- b. Aprovimin/kthimin e sasive të planifikuara të produkteve dhe treguesve të performancës në rast transferimi të fondeve dhe dërgimin për aprovim tek nëpunësi autorizues.
- c. Aprovimin/kthimin e sasive faktike të produkteve dhe treguesve të performancës, në fund të çdo katërmujori, për efekt të përgatitjes së raporteve të monitorimit dhe dërgimin për aprovim tek nëpunësi autorizues.
- d. Mbledhjen e të dhënave në lidhje me performancën e objektivave, performancën mbi secilin produkt në fund të katërmujorit dhe krahasimin e këtyre të dhënave me planin për këtë katërmujor. (Për periudhat e tjera në mënyrë progresive)
- e. Analizën e shkaqeve të deviacioneve/mospërputhjeve dhe marrjen e vendimeve në lidhje me veprimet korrigjuese, të nevojshme për përmirësimin e situatës, veçanërisht për shmangiet e theksuara nga plani sipas përcaktimit në pikën 19.2 të këtij udhëzimi.
- f. Në rast se një nga arsyet e deviances ka qenë arsye e planifikimit atëherë është e nevojshme rishikimi i planit dhe përgatitja e një përmbledhjeje të rishikuar katërmujore të shpenzimeve dhe realizimit të produkteve.
- g. Përgatitjen dhe nënshkrimin nga drejtuesi i ekipit të menaxhimit të programit (DEMP) të një raporti për Grupin e Menaxhimit Strategjik (GMS), i cili duhet të përmbajë:
 - i. Formatet e Anekseve të Monitorimit të gjeneruara nga moduli i BPPM, në sistemin AFMIS, për programin.
 - ii. Përmbledhjen e analizës së përditësuar të realizimit të shpenzimeve si edhe të realizimit të treguesve të performancës dhe të produkteve.
 - iii. Analizën që shpjegon mospërputhjet e rëndësishme në lidhje me planin, përfshirë edhe planifikimet në kuadër të buxhetit të përgjithshëm gjinor.
 - iv. Veprimet korrigjuese që EMP ka ndërmarrë, ose planifikon të ndërmarrë.
 - v. Rekomandimet për veprime të mëtejshme që janë nën përgjegjësinë e GMS, pra përtej përgjegjësisë të EMP.
- h. Identifikimin e impaktit të çdo ndryshimi në vitin buxhetor në përgatitjen e kërkesave për PBA-në e ardhshme.
- i. Organizimin e takimeve të ekipit të menaxhimit të programit në etapa të ndryshme të procesit të monitorimit, sidomos përpara periudhave të raportimit;
- j. Drejtimin e anëtarëve të ekipit të menaxhimit të programit drejt konsensusit në rastet e mosrënies dakord me probleme që lidhen me procesin e monitorimit.
- k. Nënshkrimin e raportit dhe anekseve të monitorimit të programit, përkatësisht të përgatitura nga ekipi i menaxhimit të programit dhe të gjeneruara nga moduli i BPPM, në sistemin AFMIS, për tu dorëzuar tek Grupi për Menaxhimin Strategjik.
- l. Raportimin tek koordinatori i Grupit për Menaxhimin Strategjik i të gjitha mosmarrëveshjeve të lindura brenda ekipit të menaxhimit të programit, në lidhje me procesin e monitorimit.
- m. Rishikimin e raporteve në përputhje me procedurat e prezantuara në këtë udhëzim si dhe udhëzimet e përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm, në rastet kur këto raporte të prezantuara tek Grupi për Menaxhimin Strategjik nuk janë miratuar dhe/ose nuk janë nënshkruar nga kryetari i këtij grupi.

Përgjegjësitë e anëtarëve të ekipit të menaxhimit të programit

24. Anëtarët e ekipit të menaxhimit të programit janë përgjegjës për realizimin e detyrave teknike për zbatimin e procedurave të monitorimit që prezantohen në këtë udhëzim të cilat lidhen me performancën e produkteve të programit të tyre, në sasi dhe në vlerë financiare, duke identifikuar problematikat e hasura në rast të deviacioneve ndaj planit si dhe duke bërë rekomandimet përkatëse për përmirësimin e situatës. Anëtarët e ekipit të menaxhimit të programeve kanë për detyrë:

- a. Të respektojnë afatet, cilësinë dhe standardet e raportimit të performancës së objektivave dhe të produkteve për programin përkatës sipas formateve dhe kërkesave të këtij udhëzimi të gjeneruara në modulën e BPPM në sistemin AFMIS;
- b. Gjatë vitit buxhetor rishikojnë sasitë e planifikuara të produkteve në rast transferimi të fondeve buxhetore;
- c. Gjatë vitit buxhetor, në fund të çdo katërmujori plotësojnë sasitë faktike të produkteve si edhe të dhënat faktike të treguesve të performancës, në formatet respektive në sistemin AFMIS;
- d. Të ndjekin udhëzimet e koordinatorit të Grupit për Menaxhimin Strategjik në lidhje me prioritetet e punës;
- e. Të ndjekin kalendarin e aktiviteteve të ekipit të menaxhimit të programit të hartuar nga drejtuesi i programit;
- f. Të marrin pjesë në takimet e ekipit të menaxhimit të programit të thirrura dhe drejtuar nga drejtuesi i programit;
- g. Të kontribuojnë në vendim marrjen e ekipit të menaxhimit të programit në secilën fazë të raportimit të procesit të monitorimit;
- h. Të përgatisin analizat narrative me argumentet respektive për Anekset e Monitorimit të gjeneruara nga moduli i BPPM në sistemin AFMIS, në drejtimin e drejtuesit të programit;
- i. Të bashkëpunojë me nëpunësin zbatues të njësisë së qeverisjes së përgjithshme gjatë procesit të raportimit;

25. Është e nevojshme që EMP të takohet rregullisht për të vlerësuar progresin, të testojnë supozimet dhe të vendosin në qoftë se masat korrigjuese janë të nevojshme. Masat korrigjuese duhet të ndërmerren në kohë nga EMP dhe nuk duhet të presin deri në hartimin e raportit të katërmujorit tjetër.

Përgjegjësitë e Nëpunësit Zbatues

26. Nëpunësi zbatues është përgjegjës dhe i raporton nëpunësit autorizues të njësisë si dhe drejtuesve të programeve, informacionin e nevojshëm financiar për përgatitjen e raporteve përkatëse të monitorimit.

27. Nëpunësi zbatues ka rolin e sekretarit të Grupit të Menaxhimit Strategjik të njësisë së qeverisjes qendrore. Ai mbështet Nëpunësin Autorizues gjatë procesit të përgatitjes së raporteve të monitorimit, nëpërmjet:

- a. orientimit të drejtuesve të programeve të njësisë në lidhje me performancën e shpenzimeve të programit,
- b. informimit të drejtuesve të programeve për çdo ndryshim në shpërndarjen e shpenzimeve të miratuar nga Grupi për Menaxhimin Strategjik gjatë procesit të zbatimit të buxhetit;

- c. kryerjes se analizave përkatëse bazuar në informacionin financiar dhe jo financiar të viteve të kaluara dhe vitit buxhetor aktual si dhe bërjes së opionencës gjatë diskutimit me drejtuesit e programeve për monitorimin e treguesve të performancës dhe produkteve, duke përfshirë edhe ato në kuadër të buxhetimit të përgjithshëm gjinor;
 - d. hartimit të informacionit përmbledhës të shpenzimeve faktike të njësisë, nënshkrimit të planifikimit të shpenzimeve dhe paraqitjes pranë Nëpunësit Autorizues:
28. Nëpunësi Zbatues ndihmon drejtuesin e programit për sa i përket procesit të monitorimit të produkteve të përcaktuara për programin që ai drejton dhe veçanërisht në lidhje me llogaritjen dhe analizën e kostove për njësi të tyre në përputhje me raportet e gjeneruara nga moduli i BPPM të sistemit AFMIS si dhe ndihmon në identifikimin e mundësive buxhetore të institucionit për të përballuar financiarisht realizimin e ndonjë produkti i cili është i nënfinancuar dhe është e pamundur plotësimi i kësaj kërkesë me burimet e disponueshme brenda programit.
29. Nëpunësi zbatues bashkëpunon me Drejtuesin e Programit, Nëpunësin Autorizues të nivelit të dytë si dhe anëtarët e Ekipeve të Menaxhimit të Programit, për identifikimin si dhe zgjidhjen e problemeve të hasura gjatë procesit të monitorimit, sidomos gjatë shmangies së performancës së produkteve nga planifikimi.

III.PROCEDURAT PËR PROCESIN E MONITORIMIT

Përcaktimi i Vitit Korrent

30. Viti i cili do të monitorohet, referuar këtej e tutje si viti korrent, është viti i parë i PBA-së. që i korrespondon ligjit vjetor të buxhetit. Kur procesi i PBA-së të këtë përfunduar, për vitin korrent janë përcaktuar:
- a. Alokimet sipas programeve dhe zërave të klasifikimit ekonomik të shpenzimeve (artikujve) si dhe alokimi i këtyre për projektet, produktet dhe aktivitetet;
 - b. Produktet e parashikuara për secilin program;
 - c. Kosto për njësi e planifikuar për secilin produkt;
 - d. Një ndarje (profil)4-mujor për shpenzimet dhe për çdo produkt;
31. Me marrjen e udhëzimit të Ministrisë të Financave, për zbatimin e buxhetit, Koordinatori i GMS-së udhëzon EMP të fillojnë përgatitjet për raportet e monitorimit sipas formateve, afateve dhe standardeve të kërkuara nga Ministria e Financave. Koordinatori i GMS-së përcakton datat e mbledhjeve të GMS-së që do të bëhen për të shqyrtuar raportet e monitorimit.
32. Me nisjen e procesit të zbatimit të buxhetit në fillim të vitit buxhetor, EMP duhet të marrë masat për të konfirmuar dhe siguruar burimet e informacionit të nevojshëm për të kryer monitorimin e performancës sipas standardeve të kërkuara, për të raportuar vlerat faktike të TKP-ve (treguesve kyç të performancës) në sistemin AFMIS dhe sasi të faktike të produkteve në raportet respektive të monitorimit në modulin e BPPM-së të sistemit AFMIS. Për këtë qëllim DEMP duhet të koordinojë punën me specialistët teknikë përgjegjës për mbledhjen, përpunimin dhe publikimin e të dhënave.

Procedura për përgatitjen e raporteve katërmujore të monitorimit

33. Procesi formal i raportimit mbi performancën kërkon përgatitjen e dy raporteve periodike të monitorimit, si edhe raportin vjetor mbi performancën e objektivave dhe produkteve për secilin program mbështetur në të dhënat e gjeneruara në modulin e BPPM në sistemin AFMIS. Raportet e katërmujorit dhe tetëmuorit duhet të dorëzohen tek njësi përgjegjëse për monitorimin, në Ministrinë përgjegjëse për Financat deri në fund të javës së katërt mbas përfundimit të katërmujorit

të parë dhe tetëmujaorit, përkatësisht deri në 30 Maj; dhe deri në 30 Shtator, ndërsa raporti vjetor deri në fund të muajit Shkurt të vitit të ardhshëm.

34. Menjëherë pas përfundimit të katërmujorit, Drejtuesi i Ekipit të Menaxhimit të Programit (DEMP) duhet të organizojnë një mbledhje të Ekipit të Menaxhimit të Programit (EMP) për të rishikuar të dhënat mbi performancën gjatë katërmujorit paraardhës. Nëse ka rishikim të buxhetit gjatë periudhës paraardhëse, apo ndryshime të alokimeve financiare në vitin korrent, Ekipi i Menaxhimit të Programit, përpara se të përgatisi një raport monitorimi duhet të ndjekë procedurat për rishikimin e planit të cilat jepen në shtojcat bashkëlidhur këtij udhëzimit dhe konkretisht:
- Shtojca nr.1 "Procedura për rishikimin e planit në rastin e një buxheti të rishikuar gjatë vitit korrent".
 - Shtojca nr.2 "Procedura për rishikimin e planit në rastin e ndryshimeve të alokimeve financiare në vitin korrent.
35. DEMP duhet të sigurojë të dhëna të domosdoshme mbi vlerat faktike për çdo objektiv, treguesit e performancës dhe produktet përkatëse, me qëllim që t'i paraqesë ato në mbledhjen e EMP-së.
36. Mbështetur në të dhënat e disponueshme, EMP shqyrton në se ka mospërputhje ndërmjet planit për katërmujorin dhe performancës së tij.
37. Çdo mospërputhje ndërmjet planit dhe arritjeve do të ketë implikime në strukturën e shpenzimeve dhe arritjen e produkteve në katërmujorët e tjerë të vitit korrent. EMP duhet të amendojë përmbledhjen katërmujore të shpenzimeve dhe realizimit të produkteve për të patur parasysh këto implikime. EMP duhet të diskutojë dhe të konsultohet me stafin teknik kur është e nevojshme si dhe të kërkojë të arrijë marrëveshje mbi këtë përmbledhje të rishikuar.
38. DEMP duhet të vërë në dispozicion të gjithë anëtarëve të EMP raportin e monitorimit, i cili do të përmbajë përqindjen e ndryshimit ndërmjet planit dhe faktit për çdo tregues, për çdo produkt dhe totalit për çdo program.
39. EMP duhet të rishikojë çdo mospërputhje, të diskutojë, konsultojë stafin teknik kur është e nevojshme dhe të shpjegojë arsyet e mospërputhjeve dhe veprimet që duhet të ndërmerren ose janë ndërmarrë për të zgjidhur situatën.
40. Kur EMP ka sqaruar arsyet e mospërputhjeve dhe ka përcaktuar masat korrigjuese që do të ndërmerren, DEMP duhet të përgatisë dhe të firmosë një raport për GMS-në, i cili duhet të përfshijë:
- 41.1 Raportin e monitorimit sipas anekseve të miratuara në këtë udhëzim, të gjeneruara në seksionin "Raporte dhe Aneksë", në modulin BPPM, në sistemin AFMIS.
 - 41.2 Një relacion shpjegues për mospërputhjet ndaj parashikimit të periudhës raportuese dhe masat korrigjuese që duhen ndërmarrë. Të gjitha mundësitë për veprime korrigjuese duhen marrë nga anëtarët e EMP brenda mundësive të tyre manaxheriale. Disa veprime korrigjuese mund të shkojnë përtej përgjegjësisë të anëtarëve të EMP, por brenda përgjegjësisë të antarëve të tjerë në institucion dhe disa mund të kërkojnë transferime ndërmjet programeve të institucionit (psh. një rritje neto në alokimet e programit), për të cilat është i nevojshëm një miratim i Këshillit të Ministrave. Relacioni duhet të përfshijë rekomandime me argumentet mbështetëse dhe së bashku me raportin e monitorimit duhet t'i paraqiten koordinatorit të GMS-së, jo më vonë se java e dytë mbas përfundimit të katërmujorit.
42. Raporti i monitorimit i tetëmujaorit kërkon edhe një informacion shtesë që ka të bëjë me një parashikim të realizimit të pritshëm deri në fund të vitit për treguesit kyç të performancës, për produktet edhe për shpenzimet. Ky parashikim mund të jetë i njëjtë me planin fillestar ose mund të regjistrohet një parashikim shpenzimesh dhe realizim produktesh që është më i madh ose më i

- vogël se sa plani aktual. Në relacionin narrativ që shoqëron raportin e monitorimit EMP-të duhet të shpjegojnë shkaqet dhe arësyet e ndryshimeve.
- 43 Kur një EMP nuk bie dakort mbi përmbledhjen e ndryshuar katërmujore, dhe/ose arsyet për ndonjë mospërputhje, dhe/ose veprimet korrigjuese që duhet të ndërmerren, dhe/ose pozicionin për parashikimin e fundit të vitit tek raportin i katërmujorit të tretë, atëherë DEMP duhet të përgatisë raportin personalisht dhe të paraqesë fushat e mosmarrëveshjeve.
 - 44 Nëqoftëse koordinatori i GMS-së është dakord me raportin e DEMP, ai mund ta paraqesë atë si raportin e EMP, në të kundërt, ai mund të thërrasë një mbledhje të EMP, në të cilën koordinatori i GMS-së do të marrë drejtimin, në mënyrë që të diskutojë çështjet e pazgjidhura si dhe të përpiket të arrijë një marrëveshje të re. Nëse nuk mund të arrihet një marrëveshje, koordinatori i GMS-së duhet të përgatisë vetë raportin.
 - 45 Koordinator i GMS-së përpara se të thërrasë mbledhjen e GMS-së, brenda javës së katërt mbas përfundimit të tremujorit, duhet të sigurohet që raportet nga EMP janë të plotë dhe sipas standarteve të përcaktuara në këtë udhëzim, të rishikojë implikimet e ndryshimeve të propozuara në plane për arritjen e objektivave kryesore të institucionit dhe të përgatisë një relacion shpjegues mbi këto implikime, të qarkullojë raportet nga EMP dhe relacionin shpjegues mbi implikimet tek të gjithë anëtarët e GMS-së.
 - 46 GMS duhet të marrë në konsideratë raportet nga të gjithë EMP dhe nga koordinatori i GMS-së dhe të përpiket të arrijë marrëveshje nëse duhen miratuar raportet e EMP apo duhet të kthehen për shpjegime të tjera mbi çështje specifike si dhe nëse duhen ndërmarrë veprime korrigjuese (si në rastin e ndryshimeve të buxhetit).
 - 47 Kur GMS të arrijë marrëveshjen mbi raportet e EMP, ato duhet të firmosen nga koordinatori i GMS-së dhe drejtuesi i EMP-së dhe raportet e përfunduara si: raportet e monitorimit, përfshirë dhe ato në kuadër të buxhetimit të përgjithshëm gjinor, përmbledhjet e rishikuara dhe relacionet shoqëruese që shpjegojnë mospërputhjet të dorëzohen deri në fund të javës së katërt mbas përfundimit të katërmujorit në Ministrinë përgjegjëse për Financat.
 - 48 Në rastet kur GMS nuk arrin marrëveshje, Kryetari i GMS-së ka të drejtë të marrë vendimin.

IV. RAPORTI I MONITORIMIT

- 49 Raporti i monitorimit i përgatitur nga ministritë dhe Institucionet Qendrore duhet të përmbajë:
 - a. Informacionin sipas formatit standard narrativ të raportit të monitorimit të buxhetit, të përcaktuar në Shtojcën 3, të këtij udhëzimi;
 - b. Anekset e monitorimit, të gjeneruara në modulën e BPPM, në sistemin AFMIS, si më poshtë:
 - Aneksi nr. 1 “Raporti Përmbledhës i Shpenzimeve të Ministrisë/Institucionit Buxhetor”;
 - Aneksi nr. 1.1 “Raporti i Shpenzimeve të Ministrisë/Institucionit sipas kapitujve”;
 - Aneksi nr.1.2 “Shpenzimet buxhetore në Total Programi dhe Total ministrie/institucioni qendror, sipas artikujve”;
 - Aneksi nr. 2 “Raporti mbi Ekzekutimin e Buxhetit në nivelin e Programit të Buxhetit”;
 - Aneksi nr. 2.1 “Shpenzimet e programit sipas kapitujve”;
 - Aneksi nr.3 “Raporti i performancës së produkteve të programit”;
 - Aneksi nr. 3.1 “Raporti i performancës së produkteve të programit sipas artikujve”;
 - Aneksi nr. 3.2 “Devijacioni i kostos për njësi në vite”;
 - Aneksi nr. 4 “Raporti i realizimit të treguesve të performancës së programit”.

- 50 Për gjenerimin e anekseve të monitorimit të ndiqen hapat procedurale të përcaktuara në “Manualin për Gjenerimin e Anekseve të monitorimit”, i cili është i publikuar në Modulin e BPPM në sistemin AFMIS, në seksionin “Ndihmë e Suport”.
- 51 Ministritë dhe institucionet publikojnë raportet e monitorimit dhe tabelat e anekseve në faqen zyrtare të ministrisë/institucionit, brenda katër javëve nga mbarimi i periudhës së raportimit. Publikimi i raportit dhe anekseve bëhet në format të lexueshëm nga makinat (.doc, .xls, etj).

V. TE TJERA

- 52 Paraqitja skematike e përmbledhur e procedurave të monitorimit jepet në formën e gjurmës së auditimit, bashkëlidhur këtij udhëzimi, respektivisht:
- Shtojca 4 “Gjurma e Auditit për ‘Procedura e përgatitjes së raporteve 4 mujore të monitorimit”.
 - Shtojca 5 “Gjurma e Auditit për ‘Procedura në rastin e një buxheti të rishikuar gjatë vitit korent”.
 - Shtojca 6 “Gjurma e Auditit për ‘Procedura në rastin e ndryshimeve të alokimeve financiare në vitin korrent”.
- 53 Udhëzimi nr. 22, datë 17.11.2016 “Për procedurat standarte të monitorimit të buxhetit për njësitë e qeverisjes qendrore”, shfuqizohet.
- 54 Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR

Delina IBRAHIMAJ



**Procedura për rishikimin e planit në rastin e një buxheti të rishikuar gjatë vitit
korrent.**

1. Kur Kuvendi miraton një buxhet të rishikuar, Ministria e Financave njofton institucionet buxhetore në lidhje me alokimet e tyre të rishikuara sipas programeve, artikujve dhe burimit të financimit dhe përcakton një afat përfundimtar për dorëzimin e planeve të rishikuara nga institucionet buxhetore.
2. Me marrjen e njoftimit nga Ministria e Financave, koordinatori i GMS-së duhet të udhëzojë EMP të përgatisin planet e rishikuara për Vitin Korrent brenda një afati të përcaktuar nga ai.
3. Në përgatitje të një mbledhjeje të EMP, drejtuesi i këtij ekipi duhet të identifikojë natyrën e saktë të ndryshimeve krahasuar me alokimet e mëparshme, të mbledhë çdo informacion që mund të tregojë cilat ndryshime të planit u miratuan ose priteshin. Këto mund të përfshijnë diskutimet në negociatat e buxhetit, analizën e Ministrisë së Financave të kërkesave të mëparshme ose përgjigjet për kërkesat shtesë.
4. EMP duhet më pas të diskutojë, konsultojë me stafin teknik sipas nevojës dhe të arrijë marrëveshje në lidhje me ndryshimet që do t'i bëhen planit në mënyrë që plani të përshtatet me alokimet e rishikuara. Për këtë duhet të marrë në konsideratë faktin nëse ndryshimet e propozuara do të kenë impakt mbi objektivat, standartet, projektet, produktet, aktivitetet, në alokimin e burimeve sipas artikujve, për aktivitetet të vitit korrent: Implikimet dhe ndryshimet e propozuara si në objektiva dhe në standarte duhet të reflektohen në procesin e ardhshëm të PBA.
5. Në qoftë se në ndonjë pikë në procedurat e mësipërme, EMP nuk arrin dot marrëveshje, DEMP duhet të rregullojë vetë planin dhe të lajmërojë Koordinatorin e GMS për natyrën e mosmarrëveshjeve.
6. Kur plani për vitin korrent është ndryshuar, kjo duhet të reflektohet edhe në ndryshimin e planit të produkteve në sasi dhe në vlerë për pjesën mbetëse të vitit korrent për t'iu përshtatur planit të ri.
7. Në qoftëse EMP nuk bie dakord mbi profilin e rishikuar, DEMP duhet të bëjë vetë rishikimet dhe të këshillojë koordinatoren e GMS -së për natyrën e mosmarrëveshjeve.
8. DEMP duhet të dorëzojë tek Koordinatori i GMS në përputhje me një kalendar të përgatitur nga ky i fundit një raport i cili duhet të përmbajë të gjitha raportet standarde të mëposhtëme, të cilat kanë pësuar ndryshim, si pasojë e ndryshimit të buxhetit:
 - a) Deklarata e politikës së programit;
 - b) Shpenzimet e programit sipas produkteve ;
 - c) Projekte me financim të brendshëm;
 - d) Projekte me financim të huaj;
 - e) Një profil katërmujor të rishikuar për shpenzimet dhe produktet e synuara (nga ana sasiore).
9. Koordinatorin e GMS-së duhet të shqyrtojë raportet e të gjitha programeve, planet e të cilëve janë prekur nga buxheti shtesë. GMS duhet të diskutojë, konsultojë me stafin teknik sipas

- nevojës dhe të kërkojë të arrijë marrëveshje sipas të cilës ndryshimet e propozuara të planit janë në përputhje me politikën, prioritetet dhe detyrimet.
- 9.1 Cdo rishikim i planit të buxhetit gjatë periudhës paraardhëse, përditësohet në Sistemin SIFQ dhe automatikisht reflektohet edhe në raportet dhe anekset e gjeneruara në modulën e BPPM në sistemin AFMIS.
- 9.2 Kur ndryshimi i planit të shpenzimeve për Vitin Korrent, impakton edhe ndryshimin e planit të produkteve në sasi, si edhe të treguesve të performancës, atëherë, bëhet ndryshimi përkatës i këtyre treguesve në sistemin AFMIS.
10. Koordinator i GMS-së dhe drejtuesi i EMP duhet të firmosin raportet e monitorimit dhe t'i dorëzojnë në Ministrinë përgjegjëse për Financat.

Shtojca Nr.2

Procedura për rishikimin e planit në rastin e ndryshimeve të alokimeve financiare në vitin korrent.

1. Të gjitha vendimet dhe veprimet gjatë vitit kanë si referencë planin vjetor. Por një plan nuk është i pandryshueshëm. Ngjarje të ndryshme mund të ndodhin që sygjerojnë se planet duhen të ndryshohen. Këto ngjarje mund të përfshijnë:
 - a) Ngjarje të paparashikuara dhe të paparashikueshme si psh emergjenca për të cilat nuk ekzistojnë fonde kontigjence.
 - b) Eksperienca e zbatimit tregon se parashikimet e kostove dhe/ose koha e nevojshme për zbatim janë jo të sakta dhe kanë nevojë për rishikim në mënyrë që të sigurohet realizimi i produkteve.
 - c) Planet ndikohen nga faktore të jashtëm si psh moti i keq ose ndryshime në çmimet e materialeve.
2. Aty ku ka një ndryshim në alokimin e burimeve (transferta), mund të ketë dhe ndryshime përkatëse në objektiva, ose në synime, dhe/ose cilësinë e produkteve të cilat do të realizohen. Si rregull i përgjithshëm, ndryshimet duhet të jenë minimale. Një program që ka nevojë për shumë ndryshime është një program i cili është planifikuar dobët që në fillim. Mbas tre raundeve të PBA-së, një EMP duhet të ketë besim se ka një plan të qëndrueshëm që nuk ka nevojë për shumë ndryshime në mënyrë që të zbatohet me sukses. Rrjedhimisht, kërkesat për ndryshime në buxhet nuk do të pranohen gjatë tremujorit të parë të Vitit Korrent vetëm në raste shumë specifike.

Ndryshimet e mundshme në alokimin e të ardhurave mund të marrin formën e:

 - a) Transferimit të burimeve ndërmjet njësisë shpenzuese në të njëjtin aktivitet;
 - b) Transferimit të burimeve ndërmjet aktiviteteve brenda të njëjtit produkt;
 - c) Transferimit të burimeve ndërmjet produkteve në të njëjtin program;
 - d) Transferimit të burimeve ndërmjet artikujve në të njëjtin program;
 - e) Transferimit të burimeve ndërmjet programeve në të njëjtin institucion buxhetor.

Ndryshime brenda programeve

3. Kur një EMP konsideron se vetëm një transfertë fondesh buxhetore do të jetë e mjaftueshme për të vazhduar planin dhe se një transfertë e fondeve nga i njëjti program do të jetë e përshtatshme dhe e zbatueshme, EMP duhet të kërkojë të arrijë marrëveshjen mbi njësitë shpenzuese, aktivitete dhe produkte që duhet të marrin një transfertë buxhetore dhe ato që duhet të humbin ate lidhur me;
 - i. shumën e fondeve që do të transferohet në secilin rast dhe artikujt që do të përfshihen në transfertë;
 - ii. sasinë e rishikuar për produktet që kanë një rritje të fondit të planifikuar si rezultat i kësaj transferte;
 - iii. sasinë e rishikuar të produkteve të cilat humbasin fonde si rezultat i transfertës.
 - iv. Impaktin në realizimin e objektivave tërialokimit të mësipërm.
4. Ky informacion duhet të përfshihet në relacionin mbi veprimet korrigjuese që duhen marrë dhe që i dorëzohet koordinatorit të GMS-së.
5. Kur një transfertë brenda programit është identifikuar nga EMP, sipas nevojës. Nëpunësi Autorizues duhet të paraqesë argumentat përpara GMS-së, i cili duhet të diskutojë, konsultojë

me stafin teknik dhe të arrijë marrëveshjen në qoftë se transfertat mund të mbështetët. Në mënyrë të veçantë, GMS duhet të marrë në konsideratë në se produktet me prioritet të lartë mund të realizohen në rast se burimet transferohen nga produkte me prioritet të ulët në të njëjtin program.

6. Kur transfertat nuk përfshijn krijimin e produkteve të reja ose të projekteve të reja. Nëpunësi Autorizues duhet të udhëzojë drejtuesin e EMP për të përgatitur materialet e nevojshme tek nëpunësi zbatues me qëllim që të bëjnë të mundur realizimin e transfertes sipas procedurave të përcaktuara në Udhëzimin nr. 2 dt.06.02.2012 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit".
7. Në se transfertat përfshijn krijimin e produkteve të reja ose projekteve të reja. miratimi për këtë duhet të merret respektivisht nga Nëpunësi i Parë Autorizues/Ministri përgjegjës për Financat, mbështetur në një analizë të detajuar që duhet të paraqitet nga njësi e qeverisjes qendrore mbi domosdoshmërinë e krijimit të produkteve apo projekteve të reja, si dhe impaktin që kanë ato në përmbushjen e planit.
8. Për projektet e reja të investimeve publike, Nëpunësi Autorizues i Njesisë së qeverisjes qendrore duhet të udhëzojë EMP për të përgatitur materialet e nevojshme për të realizuar rialokimin sipas Udhëzimit nr. 2 dt.06.02.2012 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit".

Ndryshime ndërmjet programeve

9. Kur një EMP e konsideron të nevojshme që për të realizuar planin nevojitet një transfertë buxhetore nga një program tjetër, EMP duhet të arrijë marrëveshje me njësitë shpenzuese nga ku duhet të marrin një transfertë;
 - a) për shumën e fondeve që kërkohen në secilin rast dhe artikujt që do të përfshihen në transfertë;
 - b) për produkt(e) që do të kenë një rritje të burimeve si rezultat i transfertës, sasinë e rishikuar të produktit që do të realizohet;
 - c) ndikimin e transfertës në objektivat dhe/ose standartet e programit;
 - d) programi(et) nga i cili EMP propozon të transferohen burimet, duke përfshirë një justifikim se pse burimet duhet të alokohen nga këto programe.
10. Ky informacion duhet të përfshihet në relacionin shpjegues mbi veprimet korrigjuese të ndërmarra që do të dorëzohet tek Nëpunësi Autorizues/Koordinatori i GMS-së.
11. Kur është identifikuar si nevojë një transfertë ndërmjet programeve nga Drejtuesi i EMP, Nëpunësi Autorizues si Koordinatori i GMS-së duhet të paraqesë argumentin në një mbledhje të GMS-së. GMS duhet të diskutojë, konsultojë me stafin teknik sipas nevojës dhe të arrijë marrëveshje në qoftë se transfertat duhet të mbështetët. Në mënyrë të veçantë, GMS duhet të konsiderojë në qoftë se produktet me prioritet të lartë mund të arrihen në qoftë se burimet janë transferuar nga produkte me prioritet të ulët në një program tjetër.
12. Në rastin kur arrihet marrëveshja sipas pikës 11, të këtij udhëzimi, Nëpunësi Autorizues duhet të përgatisë një kërkesë me anë të projektvendimit përkatës për Këshillin e Ministrave për rialokimin e fondeve midis programeve dhe duhet ta dorëzojë këtë edhe në njësinë përgjegjëse për buxhetin tek Ministria përgjegjëse për Financat. Kërkesa duhet të paraqesë impaktin e pritshëm mbi objektivat, produktet dhe shpenzimet e produkteve për secilin program të përfshirë në propozimin e transfertës. Nëpunësi Autorizues vetëm pasi ka reflektuar mendimin e Ministrisë përgjegjëse për financat mund të procedojë me paraqitjen e projektit përkatës në Këshillin e Ministrave.

13. Pasi kërkesa miratohet nga Keshilli i Ministrave, Nëpunesi Autorizues duhet të udhëzojë drejtuesin e EMP për të përgatitur materialet e nevojshme në mënyrë që transferi të realizohet sipas përcaktimeve të bëra në udhëzimin nr.2, dt.06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”.
14. Në rast se GMS nuk arrin marrëveshjen, sipas pikës 11 të këtij udhëzimi, kryetari i GMS ka të drejtën të vendosë për më tej.

Shtojca nr.3

Formati standard narrativ i raportit të monitorimit të buxhetit

Shënim: Përdorimi i këtij formati është i detyrueshëm për ministrinë e linjës dhe institucionet qendrore. Ju lutemi, ndiqni udhëzimet dhe zhvilloni më tej secilën nga çështjet e kërkuara. Mos e kaloni numrin maksimal të faqeve. Të dhënat e hollësishme duhet të prezantohen në anekset e këtij raporti.

1. Plotësimi i një liste të përmbajtjes së raportit të monitorimit.

2. Hyrje

Një përshkrim i shkurtër i ministrisë/institucionit;

- *një paraqitje e përgjithshme e çështjeve kryesore gjatë periudhës së raportit të monitorimit dhe ndonjë çështje me rëndësi gjatë periudhës së monitorimit.*

Maksimumi 0,5 faqe.

3. Informacion buxhetor i agreguar

- *Prezantoni zhvillimet kryesore buxhetore gjatë periudhës së monitorimit në nivel ministrie/institucioni; sipas programeve, sipas klasifikimit ekonomik dhe sipas burimit të financimit. Paraqisni rezultatet e arritura gjatë periudhës.*
- *Shpjegoni çdo devijim të rëndësishëm dhe krahasoni performancën me periudhën e mëparshme të raportimit. Në veçanti, theksoni nëse ekzistojnë tendenca të vazhdueshme për performancën mbi/nën nivelin e parashikuar.*
- *Te paraqiten shpjegimet perkatëse lidhur me ndryshimet e buxhetit nga plani fillestar deri në atë përfundimtar, në nivel programi dhe artikulli.*
